

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "Klea & Lois" SH.P.K.**

Sot, me datë 19/02 2018,

Zj. Valdete Sulejmani, shtetase shqiptare, lindur më 01/09/1978, në Peshkopi, Dibër, banuese në Tiranë, Rruga "Jordan Misja", Pallatet Gener 2, Seksioni D, Shk. 3, Ap. 4/2, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. 032301816, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Klea & Lois" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Klea & Lois" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Pallati Miço Sh.p.k, Shk. 1/8, Ap. 35, Yzberisht, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Tregtim, import – eksport, me shumice dhe pakice të gjitha llojeve të detergjentëve në fushën e pastrimit dhe/ose mirëmbajtjes, dizinfektantëve, produkteve për sterilizim, produkteve kimike për trajtim ujorash dhe/ose agroushqimor ose blegtoral, insekticideve, deratizantëve, bojrage industriale të ndryshme, lëndës së parë për prodhim letre për përdorime higjenike, materialeve kozmetike dhe estetike, materialeve dhe aksesorëve të ndryshëm për pastrim, materialeve të ndërtimit të ndryshme. Import dhe tregtim, lënie me qira e makinerive të madhësive të ndryshme për pastrim si dhe përdorimi i tyre sipas nevojave të kompanisë. Ndërhyrje në fushën ekologjike, rikuperimin mjedisor, pastrimin industrial, transportin, përpunimin e mbeturinave të ngurta, të mbetjeve solide pluskuese ose jo, lagia dhe larja e zonave publike, private, shërbimet e pastrimit urban dhe të higjenës mjedisore, bonifikimi i kanalizimeve, tuneleve, blerja dhe administrimi i vend shkarkimeve publike dhe/ose private. Pastrime të përgjithshme (gjenerale). Shërbime pastrimi gjatë dhe pas ndërtimit të objekteve. Shërbime pastrimi përpara hapjes së objekteve. Shërbime ditore pastrimi dhe mirëmbajtjeje. Blerje dhe shitje e makinerive për ngritje në lartësi, vincave kullë, vincave me krahë për ngritje peshash, vincave për ngritje dhe transport të mallrave në lartësi dhe lënien e tyre me qira. Tregtimi me shumice dhe pakicë i pesticideve (PMB). Shërbime pastrimi dhe dizinfektimi (DDD) të ambjenteve spitalore me rrezikshmëri të lartë, me rrezikshmëri të mesme dhe me rrezikshmëri të ulët. Ndërtimi, lyerje, trajtime lucidime të dyshemeve dhe pastrime si dhe pastrime të veprave të artit. Dezinfektim nga insekte, brejtës dhe baktere. Kryerjen e transaksioneve të



ndryshme të çdo malli, duke siguruar edhe shërbime magazinimi për të tretë në mjediset e shoqërisë. Veprimtari në fushën e ndërtimit të objekteve civile, rikonstruksione të godinave, veprave të artit, pastrim të mjediseve urbane, punime në sipërfaqe të gjelbërtë. Mirëmbajtje dhe riparime të objekteve civile dhe publike si lyerje, stukime, meremetime, punime, elektrike. Tregtim mobilje dhe materiale elektrike.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të palua jashme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- *Valdete Sulejmani*, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statutit.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Eduard Luca**, shtetas shqiptar, lindur më 08/08/1984, në Peshkopi, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. 033339295, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat liiore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin, Z. Eduard Luca**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES
VALDETE SULEJMANI

Valdete Sulejmani
SK